

URDHRI I MJEKËVE TË SHQIPËRISË KOMUNIKATË PËR SHTYP

Shkurt 2013

Fushata elektorale për zgjedhjet e 23 Qershorit siç po shihet i ka ndezur fuqishëm motorët e saj.

Urojmë të jetë një fushatë e qetë, e moralshme me alternativa e programe vizionare të besueshme dhe të zbatueshme në të mirë të këtij vendi, cilidoqoftë fituesi.

Me këtë rast, Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë bashkë me këto urime, me dashamirësi e respekt për çdo forcë politike, iu drejtohet atyre me thirrjen që të mos përdoren e shfrytëzohen spitalet dhe institucionet e tjera shëndetësore si arena të kësaj fushate.

Institucionet dhe profesionistët e shëndetit në punën e tyre brenda këtyre institucioneve, duhet të lihen të qetë, të ushtrojnë profesionin të lirë, të pavarur, jashtë ndikimeve politike dhe çdo oferte apo ndikimi tjetër qoftë, në respekt dhe përputhje të plotë vetëm me parimet dhe principet e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, si Kushtetutë e tyre profesionale.

Politizimi i mjekëve dhe ndasitë e tyre të ndikuara nga politika, dëmtojnë harmoninë, bashkëpunimin dhe integritetin profesional, të cilat do të karakterizoheshin me një impakt negativ në kujdesin shëndetësor ndaj të sëmurit dhe ulin besimin e të sëmurit ndaj mjekut për shkak të këtyre ndasive dhe bindjeve të kundërta.

Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë, ju drejtohet mjekëve dhe institucioneve shëndetësore me thirrjen, në vend të politizimit të rrisin, të pasurojnë dhe të perfeksionojnë më tej dijet dhe performancën e tyre profesionale, në vend të politizimit të rrisin profesionalizimin në mënyrë që institucionet shëndetësore të jenë më të sigurt dhe më cilësore në shërbim të të sëmurëve dhe publikut. Orientimi i vetëm i mjekëve dhe bindje e palëkundur në të gjithë veprimtarinë e tyre brenda institucioneve shëndetësore, të jetë vetëm Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

Ne i respektojmë bindjet e cilitdo prej jush. Le t'i shprehim ato jashtë institucioneve dhe tek kutia e votimit.

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.
This page will not be added after purchasing Win2PDF.